

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6758
E martë, 15 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Osmani:
Data e zgjedhjeve
në veri mund të jetë
18 dhjetori | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA DHE SERBIA MARRIN NGA BORRELLI NJË PROPOZIM PËR DALJE NGA KRIZA | FAQE 5



Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka bërë me dije se Kosovës dhe Serbisë u ka dhënë një propozim për zgjidhjen e krizës aktuale.


"Duhet të gjejmë një rrugëdalje nga kjo krizë. Kemi paraqitur një propozim për dalje nga kriza, [të cilin] duhet ta shqyrtojnë [palët]", ka theksuar Borrelli

SHKUPI DHE TIRANA NËNSHKRUAJNË 20 MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI | FAQE 5



'QYTETARËT E KOSOVËS
PRITET TË LËVIZIN PA VIZA
NGA 1 DHJETORI I 2023-s'

AKTUALE



DHJETËRA TË ARRESTUAR PËR
SULMIN NË STAMBOLL | F. 2

SHIFRA REKORDE IMIGRANTËSH
NË BRITANI, VEÇOHEN
SHQIPTARËT | F. 7

TRUSTI, 170 MILIONË EURO MË
PAK PËR NËNTË MUAJ | F. 7



EKONOMI



FMN-ja: PERSPEKTIVA EKONOMIKE
PO BËHET MË E ZYMTË | F. 8

DEPUTETËT DO TË DISKUTOJNË PËR
PROJEKTBUXHETIN E VITIT 2023 | F. 8

SPORT



14 NDESHJE TË 1/16 SË FINALES SË
KUPËS ZHVILLOHEN TË ENJTEN | F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dhjetëra të arrestuar për sulmin në Stamboll

STAMBOLL, 14 NËNTOR - Ministri i Brendshëm i Turqisë, Suleyman Soyly, tha se policia e këtij vendi ka arrestuar 22 persona të dyshuar për sulmin e së dielës në Stamboll. Në mesin e të arrestuarve, Soyly tha se është edhe personi që ka vendosur bombën. Ai nuk dha më shumë hollësi për ta, por akuzoi Partinë e Punëtorëve të Kurdistanit - një grup militant - për sulmin. Së paku gjashtë persona u vranë dhe 81 u plagosën nga shpërthimi në një zonë të frekuentuar të Stambollit. Sipas autoriteteve, shpërthimi ndodhi pasditen e së dielës në Sheshin Taksim. Zëvendëspresidenti turk, Fuat

Oktay, tha se incidenti besohet të jetë sulm terrorist, i kryer nga një grua. Presidenti Rexhep Tayyip Erdogan tha se autorët do të ndëshkohen. Duke folur në një konferencë për medie në Stamboll, ai e dënoi, siç tha, "sulmin e poshtë" dhe shtoi se "era e terrorit" është në ajër. Përgjegjësinë për sulmin deri më tash nuk e ka marrë asnjë grup. Partia e Punëtorëve të Kurdistanit, të cilën e akuzoi ministri i Brendshëm turk, është një grup militant që bën thirrje për shtet të pavarur kurd brenda Turqisë. BE-ja dhe ShBA-ja e konsiderojnë atë organizatë terroriste. Ministrja për Familje dhe Shërbime Sociale e Turqisë,

Derya Yanik, shkroi në "Twitter" se një punonjës i ministrisë dhe vajza e tij janë në mesin e viktimave. Sulmi u dënua nga përfaqësues të disa vendeve të botës. Sipas një deklaratë të sekretares për medie të Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre, Shtetet e Bashkuara qëndrojnë "krah për krah" me aleatin e tyre të NATO-s në "luftën kundër terrorizmit". "Ne ndajmë dhimbjen tuaj... Ne jemi me ju në luftën kundër terrorizmit", shkroi presidenti i Francës, Emmanuel Macron, në "Twitter". Vende, përfshirë Ukrainën, Pakistanin, Italinë dhe Greqinë, shprehën solidaritetin e tyre.



Zelensky viziton Hersonin: Jemi gati për paqe



KIEV, 14 NËNTOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka vizituar të hënën qytetin e Hersonit, i cili javën e kaluar është çliruar nga pushtimi rus. Ai foli me ushtarët e mbledhur në qytet dhe tha se Ukraina "është duke ecur përpara". Humbja e Hersonit u cilësua si zmbarsje e madhe për Rusinë. Ushtria ruse mori kontrollin e tij shumë shpejt pasi nisi pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit. Pas disa referendumeve të paligjshme që mbajti në shtator, Rusia aneksoi Hersonin, së bashku me tri rajone të tjera ukrainase. Në një ceremoni asokohe në Moskë, presidenti rus, Vladimir Putin, tha se aneksimi i Luhanskut, Donjeckut, Zaporizhjes dhe Hersonit është "i panegociueshëm". Por, javët e fundit Ukraina shënoi

fitore të mëdha në fushëbetë, duke i vënë forcat ruse nën presion. Ato u tërhoqën të premtën nga Hersoni, më pas hynë trupat ukrainase. Gjatë vizitës Zelensky tha se Ukraina është "gati për paqe, paqe për të gjithë vendin tonë". Ai falënderoi NATO-n dhe aleatët e tjerë për mbështetjen e vendit të tij në luftën kundër Rusisë. Ai tha se sistemet raketore Himars, të dërguara nga ShBA-ja, e kanë ndihmuar shumë Kievin. I pyetur nga turma se ku tjetër mund të avancojnë forcat ukrainase, Zelensky tha: "Jo në Moskë... Ne nuk jemi të interesuar për territoret e një vendi tjetër". Në një video-adresim më herët, Zelensky tha se hetuesit kanë zbuluar më shumë se 400 krime lufte në zonat e Hersonit pas largimit të forcave ruse.

Stoltenbergu: Muajt e ardhshëm do të jenë të vështirë për Ukrainën

HAGË, 14 NËNTOR - Ukraina përballet me muajt të vështirë përpara dhe kapaciteti ushtarak i Rusisë nuk duhet të nënvlerësohet, tha sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Ai e vlerësoi "guximin e jashtëzakonshëm" të forcave të Ukrainës, të cilat rikthyen kontrollin mbi rajonin e Hersonit, dhe tha se mbështetja ndërkombëtare për Kievin duhet të vazhdojë. "Muajt e ardhshëm do të jenë të vështirë. Qëllim i [presidentit rus, Vladimir] Putin është ta lërë Ukrainën në të ftohtë dhe në terr këtë dimër", ka thënë Stoltenbergu në një konferencë për medie në Hagë.

Ai ka thënë se bëhet gabim nëse nënvlerësohet Rusia, duke shtuar se forcat ruse "kanë kapacitete të konsiderueshme" si dhe "një numër të madh trupash". Tërheqja e Moskës nga Hersoni "dëshmon guximin e jashtëzakonshëm të forcave të armatosura të Ukrainës", por tregon edhe "mbështetjen tonë të vazhdueshme për Ukrainën", tha shefi i NATO-s. Stoltenberg tha se forcat ruse "kanë dëshmuar brutalitet ekstrem". "Keni parë skena të tmerrshme nga territoret e çliruara dhe sulme pa dallim ndaj civilëve dhe infrastrukturës kritike", u tha Stoltenbergu gazetarëve.



Shkupi dhe Tirana nënshkruajnë 20 marrëveshje bashkëpunimi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

SHKUP, 14 NËNTOR - Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë nënshkruar 20 marrëveshje, memorandume dhe protokolle bashkëpunimi ndërqeveritare në disa fusha, si ekonomi, shëndetësi, arsim, siguri dhe transport. Këto marrëveshje u nënshkruan në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, e cila është mbajtur më 14 nëntor në Shkup.

Memorandumet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë edhe doganat, transportin ujor dhe digjitalizimin. Ndër të tjera, është paraparë që pika e kalimit kufitar në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në Qafë-Thanë të shndërrohet si vendkalim i përbashkët.

Dy kryeministrat, Dimitar Kovaçevski dhe Edi Rama, në takimin e dy qeverive kanë folur edhe për procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, me synimin që të dyja shtetet të bëhen anëtare me të drejta të plota të unionit deri

në vitin 2030. "Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë shembull se si ndërtohen raportet e fqinjësisë së mirë. Jo shumë kohë më parë i gjithë Ballkani u mbajt peng i politikave retrograde. Nevojitet një vizion për të parë rajonin si tërësi, për të vepruar në drejtim të një të ardhmeje të përbashkët evropiane.

Marrëdhëniet dypalëshe midis Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë nuk kanë qenë kurrë më të mira sesa janë sot. Lirisht mund të themi se jemi shembull i dy fqinjëve. Ata mund dhe duhet të bashkëpunojnë drejt synimit për anëtarësim në BE", ka thënë Kovaçevski.

Duke folur për rëndësinë e bashkëpunimit mes shteteve dhe nismat rajonale, kryeministri Rama përmendi edhe Ballkanin e Hapur. "Kemi parë rezultate të mira të marrëveshjeve të arritura të Ballkanit të Hapur, ashtu sikur do të vazhdojmë të jemi edhe mbështetës të palëkundur të Procesit të Berlinit, duke pasur aftësinë që t'i shohim bashkë këto dy nisma si pjesë të njëra-tjetrës dhe në asnjë mënyrë si



përjashtuese të njëra-tjetrës", ka deklaruar Rama.

Nisma Ballkani i Hapur është vazhdimësi e Mini-Shengenit ballkanik dhe u prezantua në Novi Sad të Serbisë më 10 tetor të vitit 2019, nga lideri i Serbisë, i Maqedonisë së Veriut dhe i Shqipërisë. Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi nuk janë pjesë e saj.

Ndërsa procesi i Berlinit u vendos në vitin 2014 me iniciativën e ish-kancelares gjermane Angela Merkel, me qëllim të lidhjes dhe integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor përpara se të anëtarësohen në BE. Rama ka mirëpritur ndihmën që ka dhënë BE-ja për vendet e Ballkanit Perëndimor për përbashkë me krizën energjetike të shkaktuar nga lufta në Ukrainë, por Rama

tha se "këto fonde janë rialokim i fondeve IPA-s prandaj, sipas tij, shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë shumë ambiciozë dhe kërkuar nga Bashkimi Evropian".

Dy kryeministrat kanë diskutuar edhe për zhvillimet rajonale, me theks të veçantë konfliktin në Ukrainë, duke dënuar edhe njëherë agresionin rus.

Kovaçevski ka theksuar se dy vendet janë të vendosura qartë në vijën e politikës së jashtme të BE-së për paqen dhe ruajtjen e stabilitetit në rajon. "Në momentet kyçe për botën ne po japim kontributin tonë për paqen dhe stabilitetin në Ballkan, por edhe më gjerë në Evropë... Është në interesin tonë të përbashkët t'i parandalojmë përpjekjet e palëve të treta për qëllimet e tyre për t'i

tërhequr vendet tona dhe të gjithë Ballkanin Perëndimor në skenarë të padëshirueshëm, skenarë që kërcënojnë përfitimet demokratike për të cilat kemi punuar kaq gjatë për të rivendosur, që do t'i bllokojnë mundësitë për zhvillimin ekonomik të shteteve dhe do ta tërheqë rajonin në izolime dhe tensione të reja, të cilat Ballkani mezi i ka kapërcyer", ka thënë ai. Kjo është mbledhja e dytë mes Qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, as asaj që ishte mbajtur në Pogradec të Shqipërisë më 17 maj. Në mbledhjen e parë mes dy qeverive ishin nënshkruar disa marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi, përfshirë edhe atë për luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.



Ministria e Mbrojtjes mohon se FSK-ja nderoi pllakën dedikuar ushtarëve serbë të vrarë gjatë Luftës së Parë Botërore

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ministria e Mbrojtjes ka reaguar pas lajmeve të publikuara se Roja e Nderit e FSK-së nderon një pllakë dedikuar ushtarëve serbë të vrarë gjatë luftërave të viteve 1912-18.

Në një reagim në faqen zyrtare në "Facebook", Ministria e Mbrojtjes ka thënë se lajmi i tillë nuk është i vërtetë. "Me datën 11.11.2022 Togu i Gardës Ceremoniale dhe Orkestra Frymore e FSK-së, me ftesë të Ambasadës franceze dhe Ambasadës gjermane, ka marrë pjesë në ceremoninë e organizuar për ta nderuar rënien e ushtarëve francezë dhe gjermanë gjatë Luftës së Parë Botërore në periudhën 1914-1918. Pllakat përkujtimore të të rënëve të këtyre dy kombeve janë të vendosura në një hapësirë të përbashkët me pllakën e të rënëve serbë të vitit 1912-1918, por që si ngjarje në periudhën kohore e as me aktivitetin në fjalë nuk kanë asnjë lidhje", thuhet në reagimin e

MM-së.

Më tej ministria ka theksuar se "Togu i Gardës Ceremoniale ka marrë pjesë si formacion mbështetës i Ambasadës franceze, nën organizimin e saj, me qëllim nderimin e ushtarëve të rënë francezë dhe gjermanë". "Pozicionimi fizik i gardistëve tanë është imponuar nga pozita e pllakave memoriale dhe platesë përkatëse, dhe në asnjë formë nuk nderohen të rënë serbë. Ministria e Mbrojtjes dhe FSK nderojnë gjithmonë vetëm popujt mbrojtës të vlerave të lirisë, paqes dhe demokracisë, assesi ata që kanë qenë faktor destabilizues në secilën etapë dhe autorë të krimeve e terrorit", thuhet në reagimin e kësaj ministrie.

Reagimin për Rojën e Nderit të FSK-së që ka nderuar pllakën dedikuar ushtarëve serbë e ka bërë anëtari i kryesisë i PDK-së, Ardi Nurellari.





Kosova dhe Serbia marrin nga Borrelli një propozim për dalje nga kriza

Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka bërë me dije se i ka dorëzuar Kosovës dhe Serbisë një propozim për zgjidhjen e krizës aktuale. “Duhet të gjejmë një rrugëdalje nga kjo krizë. Kemi paraqitur një propozim për dalje nga kriza, [të cilin] duhet ta shqyrtojnë [palët]”, ka theksuar Borrelli

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka thënë se i ka dorëzuar Kosovës dhe Serbisë një propozim për zgjidhjen e krizës aktuale. “Duhet të gjejmë një rrugëdalje nga kjo krizë. Kemi paraqitur një propozim për dalje nga kriza, [të cilin] duhet ta shqyrtojnë [palët]”, ka theksuar Borrelli para një takimi të ministrave të Jashtëm të BE-së, që do të mbahet në Bruksel. Ai nuk dha detaje se çfarë përmban propozimi e as kur është dorëzuar. Tensionet midis Kosovës dhe Serbisë aktualisht janë të larta për shkak të vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin e reregjistrimit të makinave me targa të

paligjshme serbe.

Këto makina, rreth 9 000 sosh, qarkullojnë kryesisht në veri të Kosovës, ku popullata shumicë është serbe dhe kontrollohet në masë të madhe nga Beogradi zyrtar.

Qeveria e Kosovës do që të gjitha makinat të reregjistrohen me targa RKS, apo Republika e Kosovës, ndërsa Serbia kundërshton, duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Si pasojë e tensioneve të rritura, serbët e veriut i kanë braktisur institucionet e Kosovës.

Ministrat e Jashtëm të BE-së pritet të diskutojnë sot edhe për ndikimin që ka pushtimi rus i Ukrainës në rajonin e Ballkanit Perëndimor si dhe në për procesin e zgjerimit të BE-së.

Diskutimi vjen në prag të një samiti midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, që do të zhvillohet më 6 dhjetor në Tiranë.

Nga BE-ja u paralajmërua se do të diskutohet edhe për krizën energjetike në Ballkanin Perëndimor, si dhe për asistencën që blloku është duke ua ofruar vendeve të këtij rajoni në këtë aspekt. Sa iu përket raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ministrat pritet t'i përsërisin thirrjet për angazhimin konstruktiv të palëve në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në mënyrë që të ulen tensionet. Po ashtu, pritet të kërkojnë përparim në procesin e dialogut, drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme, për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Me ndërmjetësimin e BE-së, Kosova dhe Serbia janë në negociata për këtë qëllim qysh në vitin 2011. Dy vendet kanë arritur një sërë marrëveshjesh, por zbatimi i shumicës së tyre në terren ka ngecur.

Të premten e kaluar Borrelli

takoi ndarazi në Paris kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Pas këtyre takimeve, ai u bëri thirrje serbëve të veriut që të kthehen në institucionet e Kosovës dhe të vazhdojnë t'i zbatojnë përgjegjësitë e tyre.

Ai kërkoi nga të dyja palët që të gjejnë zgjidhje urgjente për krizën aktuale, ndërsa nga Kosova kërkoi edhe nisjen e bisedimeve për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Këto obligime, që dalin nga procesi i dialogut, mbeten të vlefshme dhe obliguese”, tha Borrelli.

Në BE disa diplomatë pranojnë se nuk janë të kënaqur me ecurinë e deritashme të dialogut dhe përgjegjësinë për ngecje dhe rritje të tensioneve ua bartin Beogradit dhe Prishtinës.

Pritjet kanë qenë që pas takimit të fundit midis Kurtit dhe Vuçiqit, që është zhvilluar më 18 gusht në Bruksel, të ketë më shpesh takime të tilla - së paku një herë në muaj. Por, që nga ajo kohë nuk ka pasur asnjë.

BE-ja dhe ShBA-ja i kanë

kërkuar Kosovës që ta shtyjë për dhjetë muaj zbatimin e planit për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe me qëllim shmangien e tensioneve. Qeveria e Kosovës, megjithatë, ka nisur zbatimin e tij më 1 nëntor.

Faza e parë e planit parasheh qortimin e shoferëve që vozisin makina me targa të paligjshme; e dyta parasheh gjoba prej 150 eurosh, ndërsa në të tretën do të shpërndahen targa provuese. Me këtë plan pritet që nga 21 prilli i vitit të ardhshëm në komunikacion të lejohen vetëm makina me targa RKS.

Komuniteti ndërkombëtar, gjithashtu, i ka shtuar thirrjet për Kosovën që ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Për këtë asociacion, Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje në vitin 2013, por ajo nuk është zbatuar asnjëherë.

Kurti thotë se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik.

Serbia, në anën tjetër, kërkon që asociacioni të formohet dhe të ketë kompetenca ekzekutive.

“Qytetarët e Kosovës pritet të lëvizin pa viza nga 1 dhjetori i 2023-s”



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) ka mbajtur debatin me temën “Liberalizimi i vizave për Kosovën: Fillimi i fundit”, për të diskutuar për disponimin në Bruksel dhe në vendet anëtare dhe për ta analizuar rrugën e mbetur të Kosovës deri në liberalizimin e vizave.

Në hapje të debatit, Lura Limani nga KFOS ka bërë me dije se ky diskutim është pjesë e serisë “Bisedat e hapura”. Ajo ka theksuar se së bashku me partnerët nga organizatat e shoqërisë civile për shumë vite kanë punuar që qytetarëve të Kosovës t’u mundësohet të lëvizin lirshëm. “Ne si

Fondacion kemi punuar së bashku me partnerët tanë të shoqërisë civile me vite të tëra për njohjen e të drejtës shumë bazike të lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës në zonën Schengen. Në vitin 2015 kemi zhvilluar një kampanjë mbarëkombëtare drejtuar Brukselit dhe shteteve anëtare, ku kemi mobilizuar mbi 50 mijë qytetarë të Kosovës, kemi nënshkruar peticion dhe e kemi dorëzuar në BE, me kërkesën e vetme që t’u njihet kjo e drejtë qytetarëve të Kosovës, të cilët janë të vetmit në Ballkanin Perëndimor që nuk e kanë të drejtën e lëvizjes”, ka thënë ajo. Limani ka theksuar se duket se kjo e drejtë e mohuar për

qytetarët e Kosovës është më afër se kurrë për t’u realizuar dhe në këtë debat do të diskutohet se çka mund të pritet në muajt në vazhdim.

Gazetarët Gjeraqina Tuhina dhe Augustin Palokaj, të cilët raportojnë që shumë vjet nga kryeqendra evropiane, kanë paraqitur analizën mbi procesin e liberalizimit të vizave të titulluar “Liberalizimi i vizave për Kosovën: Fillimi i fundit”. Penalistët thanë se në rast të tensionimit të situatës në veri të vendit mund të ketë ndikim në shtetet skeptike.

Tuhina vlerësoi se lufta në Ukrainë, agresioni rus, por edhe plotësimi i kriterëve, kanë shtyrë përpara procesin e liberalizimit

të vizave për Kosovën. “Në sytë tanë ka pasur një lidhje joformale të liberalizimit me procesin e dialogut dhe jo asaj që ndodhi më vonë. Çfarë ndodhi më vonë ishte 13 tetori dhe fjala ETIAS ishte fjala më e kërkuar në Kosovë në Google. Diçka e papritur, por jo e palogjikshme”, ka deklaruar Tuhina. Ajo ka thënë se Grupi Punues i Komisionit Evropian pritet të takohet më 16 nëntor, ku do ta procedojë dokumentin për liberalizimin e vizave. Prandaj, sipas Tuhinës, nëse nuk do të ketë kundërshtime nga shtetet anëtare, pritet që nga 1 dhjetori i vitit 2023 qytetarët e Kosovës të lëvizin pa viza.

Gazetari Augustin Palokaj ka

thënë se nuk beson që dialogu ka qenë pengesë për liberalizimin e vizave. Palokaj u shpreh se tani është koha e fundit e ankimit dhe vajtimit për mosliberalizim ngaqë, sipas tij, është koha e numërimit të ditëve kur do të ndodhë liberalizimi. “Zakonisht në BE nuk ekziston një arsye, por shumë. Situata në Ukrainë ka bërë që të shtyhet procesi i liberalizimit, po ashtu edhe plotësimi i kriterëve nga Kosova dhe vazhdimi i përmbushjes së kriterëve. Është fakt se janë bindur se Kosova, edhe pse nuk ka liberalizim, ka suksesin më të madh në pranimin e atyre që ilegalisht kanë qëndruar në BE”, ka thënë Palokaj.

Osmani: Data e zgjedhjeve në veri mund të jetë 18 dhjetori



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se, sipas të gjitha gjasave, data e zgjedhjeve në veri do të jetë 18 dhjetori. Sipas saj, vendimin për datën e zgjedhjeve do ta bëjë publik “sonte apo nesër në mëngjes”. Kështu ka deklaruar ajo pas takimit me përfaqësuesit e

partive politike për caktimin e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës. Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Vetëvendosjes, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe partive të tjera

minoritare në Kosovë. Të pranishëm prezent nuk kanë qenë përfaqësuesit e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ata të Listës Serbe. Katër komunat e banuara me shumicë serbe - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan - janë pa kryetarë qysh më 5 nëntor.

KFOR-i italian dhuron donacion 20 mijë euro për shkollën “Ganimete Tërbeshi” në Astrazup

MALISHEVË, 14 NËNTOR - Në ambientet e shkollës “Ganimete Tërbeshi” në Astrazup është mbajtur ceremonia e dorëzimit të donacionit që Kontingjenti Ushtarak Italian ia ka bërë Drejtorisë për Arsim dhe Edukim të komunës së Malishevës, përkatësisht shkollës fillore në Astrazup, konkretisht pajisje të teknologjisë informative: laptopë, printerë, projektorë etj, në vlerë 20 mijë euro.

Në këtë ceremoni e pranishme ishte drejtoresha për Arsim dhe Edukim, Arbëreshë Krasniqi, komandanti i Komandës Rajonale të KFOR-it në Perëndim (RC-W), kolonel Ivano Marotta me ekipin italian për Bashkëpunim Civil-Ushtarak (CIMIC), përfaqësues të tjerë të DAE-s, drejtues, mësimdhënës dhe nxënës të shkollës fillore në Astrazup.

Drejtoresha e DAE, Arbëreshë Krasniqi, në një fjalë rasti u shpreh e lumtur me bashkëpunimin në mes të KFOR-it dhe komunës së Malishevës dhe e falënderoj për zemërsisht



kontingjentin italian për këtë donacion mjaft të rëndësishëm, që ndikon në përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e

cilësisë së përgjithshme në arsim. Edhe komandanti i Komandës Rajonale të KFOR-it Perëndimor, kolonel Ivano Marotta, u shpreh i

lumtur për këtë donacion dhe theksoi gatishmërinë për ta thelluar bashkëpunimin me komunën e Malishevës në

funkcion të përkrahjes së arsimit dhe sektorëve të tjerë të rëndësishëm me interes për qytetarët.



Objektet banesore në Podujevë, me pamje të re pas përfundimit të punimeve

PODUJEVË, 14 NËNTOR - Në kuadër të projektit për meremetim të objekteve banesore, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ka përfunduar fazën e parë dhe të dytë të punimeve për renovimin e objekteve banesore në qytetin e Podujevës. Faza e parë dhe faza e dytë kanë

përfunduar me një investim prej rreth 300 mijë eurosh. Në këto investime janë përfshirë: fasadimi me termoizolim, rregullimi i pullazeve, rregullimi i ollukëve dhe ndërrimi i deryve dhe dritareve në disa prej objekteve. Komuna e Podujevës është në procedura të lidhjes së kontratës

për fazën e tretë dhe të katërt për meremetimin e objekteve të parinovuara, ku vlera e kontratës parashihet të jetë 250 mijë euro. Komuna do ta vazhdojë implementimin e projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët në banesa kolektive.

Shpërndahen fletushka informuese në Skenderaj për sëmundjen e diabetit

SKENDERAJ, 14 NËNTOR - Në kuadër të Javës së Diabetit, një ekip i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ka qëndruar në Sheshin “Adem Jashari” në Skenderaj me qëllim të informimit të qytetarëve për sëmundjen e

diabetit, simptomat dhe menaxhimin e saj, duke shpërndarë fletushka informuese për këtë sëmundje. Këtë ekip e ka vizituar edhe drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Rrezarta Hasani-Ibrahimi.



Gjini nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin “Jahjaga”

Gjakovë, 14 nëntor - Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin “Jahjaga” lidhur me programin

“Zhvillimi i njohurive mbi qeverisjen lokale” për zhvillim profesional të vajzave të reja në politikë. Përmes kësaj marrëveshjeje, vajzat, përveç anës teorike,

do ta kenë mundësinë ta ndjekin edhe fazën e praktikës në kuadër të komunës së Gjakovës. Gjatë praktikës vajzat e përzgjedhura do ta kenë

mundësinë të punojnë në institucionin e komunës dhe të mësojnë nga vetë drejtoreshat komunale, të cilat janë caktuar në rolin e mentorëve për këtë program.



Shifra rekorde imigrantësh në Britani, veçohen shqiptarët

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Numri i emigrantëve që kalojnë Kanalin Anglez për të mbërritur në Britani të Madhe ka arritur deri më tash këtë vit në më shumë se 40 000, tha Ministria e Mbrojtjes e Britanisë. Sipas shifrave të saj, 972 njerëz, me 22 varka, kanë kaluar kanalin vetëm të shtunën, duke çuar totalin në 40 885. Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar se shifra është rekorde dhe veçoi imigrantët shqiptarë, iranianë dhe ata afganë. "Gjatë gjithë vitit të kaluar janë

regjistruar 28 526 kalime të kanalit - shifër edhe kjo rekorde për kohën", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes. Shifrat në rritje vënë presion mbi Qeverinë e Britanisë, pasi Partia Konservatore në pushtet e ka bërë trajtimin e imigracionit prioritet kryesor. Çështja është bërë, po ashtu, për shkak tensionesh me Francën, nga ku nis Kanali Anglez. Dy vendet janë duke bërë përpjekje për të gjetur zgjidhje. Ato nënshkruan mëngjesin e së

hënës një marrëveshje me vlerë prej 72.2 milionë eurosh për forcimin e kontrolleve policore. Ministri i Brendshëm i Francës, Gerald Darmanin, priti homologen e tij britanike, Suella Braverman, në Paris, për nënshkrimin e marrëveshjes. "Është në interesin e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe asaj franceze që të punojnë së bashku për ta zgjidhur këtë problem kompleks", tha Braverman në një deklaratë pas takimit. Braverman, ditë më parë, e ka



cilësuar fluksin e imigrantëve që mbërrijnë në Mbretërinë e Bashkuar si "pushtim". Kombet e Bashkuara kanë thënë se komentet e tilla janë "të tmerrshme".

Mediet në Britani kanë raportuar të shtunën për një protestë të komunitetit shqiptar në Londër kundër komenteve të ministres Braverman.

Jozsef Szpisnjak emërohet zëvendëskomandant i ri i KFOR-it



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Në kampin e KFOR-it në Prishtinë të hënën është bërë ndërrimi i komandës së zëvendëskomandantit të KFOR-it. Gjatë kësaj ceremonie zëvendëskomandanti i deritanishëm, gjenerali italian Luca Piperni, ia dorëzoi detyrën gjeneralit hungarez Jozsef Szpisnjak. Komandanti i KFOR-it në Kosovë, Angelo Michele Ristuccia, e ka uruar ish-zëvendëskomandantin tashmë të KFOR-it për punën e

mirë që ka bërë gjatë misionit të tij. Ristuccia ka thënë se, përkundër që ka qenë vit sfidues, nën udhëheqjen e gjeneralit italian Luca Piperni janë bërë hapa dhe përparime që kanë ndihmuar në përmbushjen e mandatit të KFOR-it në Kosovë. "Ndikimi juaj ishte aq i madh 20 vjet më parë sa NATO ju riktheu për ta vazhduar traditën e ekselencës si zëvendëskomandant i KFOR-it. E di që ky vit ka qenë sfidues, por ju

keni bërë hapa dhe përparim të jashtëzakonshëm për të ndihmuar në përmbushjen e mandatit tonë dhe për të ofruar asgjë tjetër përveç më të mirës këtu në Kosovë. Më lejoni të nënvizoj disa nga arritjet tuaja që përmirësojnë aftësitë tona si organizatë. Ju drejtuat përpjekjet në bashkëpunimin tonë kolektiv dhe dialogun transparent me Policinë e Kosovës. Ju keni qenë në gjendje të zhvillonit programe dhe praktika në të cilat ndihmuar

dekonfliktin dhe koordinimin e hapësirës sonë ajrore për Sistemet e Avionëve pa Pilot - UAS. Gjithashtu, keni krijuar një metodologji dhe sistem në të cilin Ekipet e Monitorimit të Ndërlidhjes - LMT mund të ofrojnë funksionalisht informacion për atmosferat e bazuara në tokë në pamjen strategjike operacionale, dhe keni qenë i dobishëm në ofrimin e mbikëqyrjes dhe udhëheqjes gjatë Golden Saber & Frozen Sabre", ka

thënë ai. Komandanti i KFOR-it, duke i uruar mirëseardhje zëvendëskomandantit të ri të KFOR-it, Jozsef Szpisnjak, i shprehu besimin e tij se do të sjellë profesionalizëm dhe integritet. Gjenerali italian Luca Piperni u shpreh se, përkundër që ka qenë dëshmitar i shumë ndryshimeve në Kosovës, sipas tij, asgjë nuk ka ndryshuar në gatishmërinë e NATO-s për të kontribuar në stabilitetin e Kosovës.

Trusti, 170 milionë euro më pak për nëntë muaj

Prishtinë, 14 nëntor - Mbi 170 milionë euro. Kaq para janë humbur nga janari e deri në shtator nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, ka njoftuar Banka Qendrore e Kosovës përmes publikimit të Raportit për Sistemin Financiar. Në raport thuhet se vlera e përgjithshme e Fondeve të

Trustit është mbi 2.3 miliardë euro. Në anën tjetër në Kuvendin e Kosovës do të bëhet edhe një tentativë për ta tejkuluar projektligjin që ua mundëson qytetarëve tërheqjen e 30 për qind të kursimeve, pasi që kishte dështuar herën e parë në muajin qershor.

Tërheqjen e 30-përqindëshit e kishte kundërshtuar partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje. Por, muaj më parë qe organizuar një peticion, të cilit qytetarët i qenë përgjigjur masivisht. Mbi 17 mijë nënshkrime janë pranuar si të vlefshme nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



FMN-ja: Perspektiva ekonomike po bëhet më e zymtë

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Perspektiva globale ekonomike është më e zymtë se parashikimet e muajit të kaluar, tha Fondi Monetar Ndërkombëtar. Shkaqet kryesore për këtë, sipas FMN-së, janë inflacioni në rritje dhe pasiguria ushqimore e shkaktuar nga lufta e Rusisë në Ukrainë. Muajin e kaluar FMN-ja uli parashikimin e saj për rritjen ekonomike në vitin 2023 në 2.7 për qind, nga një parashikim i mëparshëm prej 2.9-përqindësh.

Në një raport të përgatitur për samitin e grupit të vendeve më të industrializuara, G20, që do të mbahet në Indonezi të martën, FMN-ja ka njoftuar se treguesit e fundit "konfirmojnë se perspektiva është edhe më e zymtë", sidomos në Evropë. "Sfidat, me të cilat po përballet ekonomia globale, janë të mëdha dhe indikacionet ekonomike tregojnë sfida të tjera përpara", ka njoftuar FMN-ja, duke shtuar se mjedisi aktual i politikës është "jashtëzakonisht i pasigurt". Përkeqësimi i krizës energjetike

në Evropë do ta dëmtonte rëndë rritjen ekonomike dhe do ta rriste inflacionin, paralajmëroi huadhënësi global. Inflacioni në gjithë botën ka nisur të rritet fillimisht për shkak të pandemisë së koronavirusit. Rritja ka vazhduar edhe pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit. Këto dy vende janë ndër eksportueset më të mëdha të drithërave në botë. FMN-ja paralajmëroi se edhe moti gjithnjë e më ekstrem mund ta dëmtojë rritjen ekonomike.



Kosova planifikon investime në energji në vlerë prej 4.5 miliardë eurosh deri në vitin 2031



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Në Forumin Ekonomik të Vjenës, kryeministri Albin Kurti ka thënë se deri në vitin 2031 Kosova planifikon investime në energji në vlerë prej 4.5 miliardë eurosh. Në kryeqendrën austriake Kurti ka folur edhe për zhvillimet ekonomike në vend. "Qeveria e Kosovës momentalisht është duke planifikuar investime 4.5 miliardë euro për energji të pastër në Kosovë. Në duam ta

marrim modelin austriak dhe gjerman të edukimit dual, e cili do të tejkalojë dhe bëhet urë lidhëse profesionale, kështu që është e pamundur të kemi një rritje ekonomike pa profesionistë. Kështu që duhet të kemi punë në tregun e punës për të pasur ngritje të qëndrueshmërisë. Sa i përket energjisë së ripërtëritshme, qëllimi ynë në strategji është të vazhdojmë me dekarbonizim

dhe eficientë për energji dhe ta mbrojmë konsumatorin", ka theksuar Kurti, duke shtuar se Kosova ka një strategji mbicioze e cila është në bazë të Deklaratës së Sofjes. "Nga viti 2031 duam të prodhojmë energji elektrike 400 MWh nga era apo 35 për qind të prodhimit të përgjithshëm. Këtë vit kemi rritur rreth 6 për qind buxhetin për këtë sektor dhe kursim të energjisë. Nga viti i ardhshëm do ta fillojmë

ndërtimin e projekteve për energji të ripërtëritshme", ka deklaruar Kurti. Po ashtu, ai ka theksuar se ekonomia e Kosovës është duke u rritur shpejt. "Rritja ekonomike e Kosovës për vitin 2021 është 10.7 për qind, e cila ishte më e larta në rajon dhe më madhja që nga pas lufta. Po ashtu, kemi pasur rritje të PBB-së me 4 për qind dhe numër të investimeve strategjike, të cilat

janë rritur 87 për qind dhe 88 për qind ngritje të eksportit. Pra, shumë është bërë, por edhe shumë mbetet të bëhet. Stabiliteti politik është treguar i favorshëm edhe për ambicjet tona. Por, këtë rritjen ekonomike nuk duam ta mbajmë për shtetin, por të shpërndajmë për popullin dhe këtë vit kemi vazhduar me rritje dhe duam ta ndalojmë ndikimin e inflacionit", ka theksuar Kurti.

Deputetët do të diskutojnë për projektbuxhetin e vitit 2023

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës do të mbledhen në dy seanca plenare gjatë kësaj jave. Të enjten do të mbahet seanca e re plenare, në të cilën pritet të diskutohet për buxhetin e vitit 2023, ndërsa të premten do të trajtohen pikat e mbetura nga seancat e kaluara. Kjo u bë me dije pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit të mbajtur të hënën. "Kryesia e

Kuvendit mori vendim që këtë javë të kemi dy seanca, të enjten seancë plenare të re, kurse të premten vazhdim i pikave të papërfunduara nga seancat e mëhershme. Gjithashtu, caktuam edhe rendin e ditës për seancën e 24 nëntorit. Të enjten do ta kemi vetëm Projektligjin për Buxhetin e vitit 2023", ka thënë deputeti i LV-së, Adnan Rrustemi.

Në fund të muajit tetor, Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Buxhetin e vitit 2023, i cili pritet të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro. Një miliard e 98 milionë euro janë ndarë për subvencione e transferime, 811 milionë në shpenzime kapitale, 745 milionë të tjera në kategorinë 'paga dhe mëditje' dhe 493 milionë euro në mallra dhe shërbime.



Rikthimi i Shën Naumin, nën administrimin e Shqipërisë më 1941



Nga: Haqif MULLIQI

Një dokument në dosjen "Ekstrakte nga Kosova" e Foreign Office-it, bën një rikthim në kohë, suke sjellë citate dhe komente të shtypit evropian mbi kryengritjen shqiptare kundër xhonturqve mes viteve 1910-1911. Qëllimi i administratës britanike, dhe në veçanti diplomacisë së saj, ishte t'i përafrojë gjenezën e disa problemeve që u bartën për tre dekada e gjysmë si probleme që gjenerojnë konflikte në Ballkan.

Ndërsa, në artikullin "F" të kësaj dosjeje hasim pyetjen mjaft interesante: I kujt është Shën Naumi?

Ja se çfarë shkruan gazeta bullgare "La parole Bulgare" (gazetë kjo që botohej në gjuhën frenge), nr. 822 e datës 18 dhjetor 1943:

"Manastiri i Shën Naumit dhe kisha e Shën Klementit janë dy vende të shenjta për Bullgarinë. Këta të shenjtë kanë përhapur kulturën bullgare kudo që kanë shkuar. Shën Naumi ishte nxënë i vëllezërve Qirili dhe Metodi. Ai u dërgua në Maqedoninë Perëndimore nga car Borisi, ngase, ajo pjesë e Bullgarisë po bëhej çdo ditë e më e rëndësishme. Tashmë janë bërë mbi një mijë vjet qëkur ai fanar drite qëndron atje si shenjë e kulturës bullgare në Maqedoninë Perëndimore. Sa herë që vendi ndodhet nën shtypjen e huaj, ai manastir ishte gjithmonë një seli e sentimentit bullgar".

Ja çfarë thotë historia, thonë ekspertët britanik lidhur me manastirin e kontestueshëm në cep të brigjeve të Liqenit të Ohrit: "Pas ndarjes së Perandorisë romake në dy pjesë", shkruajnë ekspertët britanikë, "Gadishulli Ballkanik mbeti nën administrimin e pjesës lindore, gjegjësisht të Perandorisë së Bizantit. Ndodhën shumë invadime, por në shekullin IV aty u vendosën barbarët sllavë dhe më vonë edhe bullgarët, të cilët u asimiluan shpejtë nga sllavët, bile, para se të kalonin vargmalet", komentojnë në mënyrë ironike, britanikët. "Një pjesë e maqedonasve, të cilët ishin të një familjeje me ilirët, me trakasit dhe me epirotët, u mbytën (vranë), ndërsa një pjesë tjetër u asimilua nga sllavët, ndërsa pjesa tjetër ruajti gjuhën e vjetër (trako-ilirishte ose shqiptare).

Qirili dhe Metodi ishin nga Selaniku, me prejardhje greke. I pari ishte në shërbim të perandorit

bizantin, si bibliotekist, i dyti administrator në Azinë e Vogël. Me qëllim të kundërvënies së fesë katolike që po përhapej shpejt ndër sllavët e Moravisë dhe të Çekoslovakisë, perandori e dërgoi atje Qirilin.

Qirili zbuloi alfabetin sllav dhe së bashku me vëllain e vet, ndihmoi shumë në përhapjen e influencës së lindjes në këto provinca. Në mesin e nxënësve të tyre ishin Gorazhdi, Angelari – që përmirësojnë alfabetin – Lorenci, Klementi, Naumi etj. Ata detyrohen ta braktisin Moravinë dhe Çekoslovakinë, për shkak të përhapjes së katolicizmit, dhe të shkojnë në Beograd. Më vonë Klementi, për t'u bërë pastaj peshkop i Dibrës (Dibrës së sotme), me Ohrin si qendër. Naumi u tërhoq në bregun e Liqenit të Ohrit dhe themeloi manastirin i cili sot e mban emrin e tij, të cilin ai vetë e kishte quajtur Shën Arkangjeli. Nga viti 910, kur vdiq Naumi e deri më 1912 ky manastir është administruar nga priftërinjtë që vareshin nga Patrikana e Stambollit, përveç një kohe të shkurtër që zgjati katër vjet, nga viti 1870-1874, kur u administrua nga priftërinj maqedonas – të varur nga kisha bullgare, përsëri me seli në Stamboll.

Pas vitit 1912, ky manastir udhëhiqej nga shteti të cilin ia përcaktonin, edhe pse ky manastir ka qenë shkak për grindje në mes të shqiptarëve dhe të jugosllavëve.

Në Konferencën e Londrës kjo çështje u zgjidh në favor të Shqipërisë, ndërsa me Protokollin e Firences, në Konferencën e Parisit, në Ligën e Kombeve dhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, përkundër të gjitha vendimeve ndërkombëtare, siç do të sqarohet më vonë, ky manastir, faktikisht mbeti nën Jugosllavi. Pas çanëtarësimit të Jugosllavisë, ky manastir erdhi nën administrimin shqiptar,

"Në aspektin fetar apo religjioz", do të konstatojnë me këtë rast ekspertët britanik, "ky manastir ka më tepër rëndësi për Shqipërinë se sa për Jugosllavinë sepse, çdo vit, gjithnjë e më shumë shqiptarë e kanë vizituar atë, ndërkaq kishte shumë më pak serbë. Përveç kësaj, edhe prifti kryesor është një shqiptar nga Berati", thonë këta ekspert për t'u zgjeruar në këtë pjesë të dokumentit me atë se si është diskutuar në fat çështja e këtij manastiri prej viti në vit, siç thonë ata, dhe prej vendi në vend.

"Më 1913, Konferenca e Londrës ia dha Shqipërisë Bregun Perëndimor të Ohrit", thonë britanikët, "nga fshati Linit e deri tek Manastiri i Shën Naumit. Komisioni ndërkombëtar për caktimin e kufijve filloi të punojë në tetor të vitit 1912. Ata filluan ndarjen e fshatit Lin dhe vazhduan lartë deri në malet e Korabit. Më pas, për shkak të dimrit ndaluan punën, për ta rifilluar serish në pranverë të vitit 1914. Vazhduan caktimin e kufijve të Shkodrës. Para

se të mund ta fillonin punën nga jugu, atyre iu desh ta ndërprisnin këtë për shkak të luftës botërore. Kështu, çështja e manastirit ngeli edhe çështje e kontestuar. Konferenca e Parisit më 1921 konfirmoi vendimin e vitit 1913, e më pas edhe Konferenca e Ambasadorëve e 6 dhjetorit të vitit 1922, ia dha manastirin Shqipërisë", shkruajnë profesorët e Baliolit.

Pas këtij vendimi në favor të Shqipërisë, siç ishte e pritur, do të reagonte qeveria e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, ndaj dhe kjo çështje iu parashtrua Ligës së Kombeve, e cila vendosi që këtë kontest, ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë Jugosllave, ta zgjidh Gjykata Ndërkombëtare e Hagës, kështu që vendimi i 6 dhjetorit të vitit 1922 u rikonfirmua, duke filluar nga Liqeni i Ohrit nëpër bregun perëndimor të Çevarës, nja 750 metra në veriperëndim të manastirit, më pas në afërsi të rrugës Korçë-Pogradec, duke shkuar në lindje, duke e lënë Alikapinë në Shqipëri, e Peshkopinë, Lubanishtën dhe Trabezicën në Jugosllavi. Mirëpo, ky vendim u refuzua nga Jugosllavia. Kështu, në negociatat që u zhvilluan gjatë vitit 1925, qeveria e Beogradit doli se ishte e gatshme që të hiqte dorë nga Vermoshi që ta merrte Shën Naumin. Ndërsa, qeveria shqiptare, e këshilluar që t'i hulumtonte dhe shqyrtonte këto mundësi, në fund e arriti këtë

marrëveshje lidhur me këto negociata, kështu që Shën Naumi iu dha Serbisë, do të thotë Jugosllavisë, me ç'rast u përmirësuan kufijtë rreth Krajës, ndërsa Shqipëria e mori edhe Vermoshin. Gjithashtu, me këtë marrëveshje të kontestuar, edhe sot e kësaj dite, trembëdhjetë fshatra rreth Peshkopisë dhe brigjet rreth (në perëndim dhe jugperëndim) manastirit i takuan Shqipërisë.

"Më vonë", shkruajnë ekspertët e Baliolit, "u mor vendimi (me protokollin e Firences të 26 qershorit 1926) që shqiptarët të mund të shkonin në manastir me varka kufiri, për të qëndruar, vetëm për çështje fetare, jo më shumë se tri ditë".

Më pas, me fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me shpërbërjen e Jugosllavisë mbretërore, u mor vendimi që Shqipëria ta rikthejë Shën Naumin dhe nënprefekturën e Prespës, aq më tepër duke pasur parasysh faktin se pjesa dërmuese e popullatës së kësaj ane ishin shqiptarë etnik. Fillimisht kjo edhe ndodhi kështu, por gjërat ndryshuan më pas, pas kapitullimit të Italisë, kur bullgarët, të prirë nga situata në porsakrijuar dhe kaosi që po mbretëronte gjithandej, ia dolën që ta pushtojnë këtë territor etnikisht dhe legalisht shqiptar me çfarë shkaktuan çarje të mëdha në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve gjë që, në këtë kohë mund të konsiderohej e dëmshme sidomos për bullgarët dhe Bullgarinë.





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Maraj jep dorëheqje nga pozita e kryetarit të KB Sigal Prishtina

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Burim Maraj ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të Klubit të Basketbollit Sigal Prishtina. Lajmin e ka dhënë Maraj në "Facebook". Maraj ka thënë se për shkak të

angazhimeve të tjera personale po largohet pas dy vjetëve nga Sigal Prishtina. "Pas pothuajse dy vjetëve në krye të klubit më të mirë në botë, e pas rreth tri dekadave si lojtar dhe anëtar i tij, duke

tejkalar shumë sfida dhe përjetuar shumë kënaqësi, për arsye personale që lidhen me angazhimet e mia të reja, sot kërkova nga bordi i klubit të më lirojë nga pozita e kryetarit", ka

shkruar Maraj, i cili ka falënderuar klubin për rrugëtimin e përbashkët, ndërsa ka thënë se ishte privilegj që e drejtoi një skuadër kaq të madhe në vend.



14 ndeshje të 1/16 së finales së Kupës zhvillohen të enjten

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Komisioni i Garave në Federatën e Futbollit të Kosovës e ka caktuar orarin e ndeshjeve të 1/16 së finales së Kupës së Kosovës. Përveç ndeshjeve Drita - Liria dhe Phoenix - Ballkani, që luhen më 23 dhe 24 nëntor, të gjitha ndeshjet e tjera luhen më 17 nëntor, me fillim në orën 12:00.

Njëra prej ndeshjeve më interesante në këtë rreth të garës së Kupës zhvillohet në Gjakovë në mes rivalëve të vjetër, Vëllaznimit dhe Prishtinës. Ani pse këto dy skuadra momentalisht kanë kualitete të ndryshme, përballja mes tyre po pritët me një entuziazëm të madh. Ndërsa fituesi në fuqi i Kupës, Llapi, në stadiumin "Zahir Pajaziti" e pret skuadrën Vllaznia Pozhoran, derisa interesante pritët të jetë edhe ndeshja e dy klubeve nga Rrafshi i Dukagjinit, Dukagjini dhe Rilindja 1974. Në Skenderaj përballen skuadrat kuqezi, Drenica dhe Flamurtari nga Prishtina.



1/16 e Kupës

Të enjten takohen:
Llapi - Vllaznia Pozhoran
Vëllaznimit - Prishtina
Dukagjini - Rilindja 1974
Prizreni - Istogu
Feronikeli '74 - 2 Korriku
Vushtrria - Drenasi
Vjosa - Ulpiana
Drenica - Flamurtari
Behari - Ferizaj
A&N - Rahoveci
Fushë Kosova - Arbëria
Ramiz Sadiku - Malisheva
Trepça '89 - Kika
Trepça - Gjilani (ndeshja luhet në Gjilan)

Më 23 nëntor takohen:
Drita - Liria

Më 24 nëntor takohen:
Phoenix - Ballkani

Audrius Prakuraitis, trajner i ri i KB Bashkimi



PRIZREN, 14 NËNTOR - KB Bashkimi është bërë me trajner të ri. Prizrenasit kanë njoftuar sot se e kanë angazhuar trajnerin nga Lituania, Audrius Prakuraitis. Ky i fundit e njeh mirë basketbollin e Kosovës për faktin se në edicionin 2016/17 e kishte fituar titullin dhe Kupën me skuadrën e Prishtinës. "Për ta ngritur nivelin e lojës së ekipit

tonë, kryesia e KB Bashkimi ka vendosur që ekipit tonë t'i bashkohet një trajner kampion dhe fitues i Kupës në Kosovë. Bëhet fjalë për trajnerin e mirënjohur nga Lituania, Audrius Prakuraitis, me të cilin synojmë suksese të mëdha me ekipin tonë. Prakuraitis në sezonin 2016/17 pati dominuar plotësisht në basketbollin

kosovar, duke fituar titullin dhe Kupën me Prishtinën dhe e njeh shumë mirë ligën tonë", thuhet në njoftimin e klubit prizrenas. Audrius Prakuraitis pati karrierë të suksesshme edhe në Rumani, Estoni, Ukrainë dhe Bahrein. Aftësitë e tij për ta drejtuar ekipin drejt sukseseve e bëjnë të veçantë trajnerin e njohur nga Lituania.

Ronaldo 'shpërthen' kundër Unitedit: Jam tradhtuar nga klubi

MANCHESTER, 14 NËNTOR - Cristiano Ronaldo ka dhënë një intervistë ekskluzive për Piers Morgan. Ylli portugez ka dhënë një prej intervistave më "tronditëse" vitet e fundit. Pesë herë fituesi i "Topit të Artë" është shprehur se ndihet i tradhtuar nga Unitedi lidhur me ngjarjet e fundit. Ai ka folur edhe për raportin e tij me trajnerin Ten Hag. "Po, ndihem i tradhtuar. Jo vetëm

nga trajneri, por edhe nga 2-3 persona të tjerë. Por, s'më intereson. Ndihem i tradhtuar dhe besoj se disa njerëz këtu nuk më duan, jo vetëm këtë vit, por edhe vitin e kaluar", ka thënë portugezi. "Nuk kam respekt për të, pasi ai s'ka respekt për mua", ka thënë Ronaldo. "Nëse ti nuk ke respekt për mua, unë kurrë s'do të kem respekt për ty. Unë ndoqa zemrën time", thotë ai

thjesht, duke rrahur gjoksin. "Ai (Sir Alex) më tha: 'Është e pamundur për ty të shkosh te Manchester City' dhe unë i thashë: 'Ok-ej, Bos'. Përparimi ishte zero. Që kur Sir Alex u largua, unë nuk pashë asnjë evolucion në klub. Asgjë nuk kishte ndryshuar". Më tutje, CR7 komentoi edhe kritikën e Wayne Rooney. "Nuk e di pse më kritikoi aq keq... ndoshta sepse ai e përfundoi

karrierën e tij dhe unë luaj akoma në nivele të larta. Nuk po them që unë dukem më mirë sesa ai. Gjë që është e vërtetë", ka thënë Ronaldo. Mes të tjerash, Ronaldo ka thënë se klubi nuk tregoi empati kur vajza e tij e porsalindur ndërronte jetë. Ronaldo ndihet i tradhtuar nga klubi dhe thotë se kjo histori nuk supozohej të përfundonte kështu. Kjo



intervistë duket si një lloj përhëndetje e ashpër e Cristiano Ronaldos me skuadrën e Unitedit. Ronaldo e dha këtë intervistë për Piers Morgan dhe intervista u publikua ekskluzivisht në "The Sun".

Enea Koliçi, 'ylli i javës' në Superligë

GJILAN, 14 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ndarjen e çmimit "ylli i javës" pas çdo xhiroje në Albi Mall Superligë. Çmimi i më të mirit për javën e 17 i ka takuar portierit të SC

Gjilani, Enea Koliçi. Ky i fundit ishte më i merituari që skuadra e tij realizoi fitore shumë të rëndësishme si mysafire kundër Llapit (1:0). Ai gjatë lojës u tregua vendimtar me disa në intervenime, duke mos lejuar

që porta e tij të mposhtet. "Faleminderit shumë komisionit! Ky është një vlerësim i rëndësishëm për mua, të cilin dua t'ia dedikoj klubit dhe bashkëlojtarëve të mi. Ndeshja me Llapin ishte shumë e vështirë dhe e

përgëzoj ekipin për angazhimin. Jam i lumtur që dolëm me pikë të plota nga kjo sfidë. Tani ka mbetur edhe një ndeshje e vështirë për ne, por shpresoj ta mbyllim këtë stinor vjeshtor sa më mirë", ka thënë Koliçi.



Ramosi i zhgënjyer që mbeti jashtë Botërorit: Fatkeqësisht duhet ta shikoj nga shtëpia

PARIS, 14 NËNTOR - Sergio Ramos e mbajti të paprekur deri në momentin e fundit iluzionin e të qenit në "Katar 2022". Megjithatë, Luis Enrique nuk e përfshiu në listën finale, duke qëndruar besnik ndaj ideve të tij. Qendërmbrojtësi, ende në procesin e tretjes së këtij lajmi, e ka rrëfyer zhgënjimin e tij në rrjetet sociale.

"Kupa e Botës? Sigurisht që ishte një nga ato ëndrrat e mëdha që duhej të realizoja.

Do të ishte e pesta por, fatkeqësisht, do të më duhet ta shikoj nga shtëpia ime", ka shkruar Ramosi në "Instagram". Pas një viti të parë fatal te PSG-ja, i prekur nga lëndimet e shumta, ai tashmë është një nga titullarët e padiskutueshëm për Christophe Galtier, në boshtin e mbrojtjes parisienne. "Sezoni i kaluar ishte i vështirë, por punova me trup dhe shpirt



për t'u rikuperuar. Unë përsëri u udhëhoqa nga qëllimet dhe iluzionet që njeriu i vendos gjithmonë vetes. Për fat të mirë mund të them se ndihem sërish vetvetja, e shijoj futbollin, klubin tim dhe një qytet të madh si Parisi. Është e vështirë, por çdo ditë dielli del përsëri. Absolutisht asgjë nuk do të ndryshojë tek unë. As

mentaliteti im, as pasioni im, as këmbëngulja ime, as munda dhe përkushtimi im 24 orësh, duke menduar për futbollin. Kjo është ndjesia ime dhe doja ta ndaja me ju. Faleminderit të gjithëve për dashurinë! Kam shumë sfida dhe synime për të realizuar. Ju uroj më të mirat! Forcë, Spanjë!", ka deklaruar Ramosi.

Lakersat mposhtin Brooklynin, zhgënjën Golden State

LOS ANXHELOS, 14 NËNTOR - Skuadra e lakersve rikthehet te fitorja, duke mposhtur një skuadër pretendente për titull si Brooklyn. Kalifornianët fituan me rezultat 116-103, sfidë ku shkëlqyen Anthony Davis (37 pikë e 18 rebounde) e Loonie Walker me 25 pikë. Për Brooklynin u dallua Duranti me 31 pikë, por që mbetën për statistikë. Zhgënjën sërish skuadra kampione e Golden State Warriorsit, që u mund nga Memphisit (122-115), duke mos



fituar ende jashtë fushës këtë sezon. Curry me 27 pikë e Wiggins me 26 u përpoqën t'i japin fitoren skuadrës kampione, por pa sukses. Për Memphisin u dallua Sabonis me 26 pikë e 22 rebounde. Fiton Philadelphia, që falë 59 pikëve e 11 reboundeve të Joel Embiidit,

mundi me rezultat 105-98 Utah Jazzin. Ndeshje e mirë edhe për Porterin që, falë 31 pikëve, i dha fitoren Denverit ndaj Chicagos, me shifrat 126-103. Ndërsa Minnesota, falë 30 pikëve të Russellit dhe 29 të Townsit, mundi me rezultat 129-124 Clevelandin jashtë fushës.

REZULTATET

3		
New York - Oklahoma	135-145	
Cleveland - Minnesota	124-129	
Washington - Memphis	102-92	
Philadelphia - Utah Jazz	105-98	
Chicago - Denver	103-126	
Sacramento - Golden S.	122-115	
Lakers - Brooklyn	116-103	

Dortmundi pranon shitjen e Bellinghamit

Jude Bellingham është një nga mesfushorët më të vlerësuar në botë për momentin. 19-vjeçari anglez ka treguar formë të lartë me Borussia Dortmundin ndhe çmimi i tij është 100 milionë euro.

Bellingham iu bashkua Dortmundit në verën e vitit 2020 nga Birmingham City për 25 milionë euro, derisa largimi i tij nga "Signal Iduna Park" pritet të ndodhë në janar ose në verë.

Skuadrat e mëdha si Chelsea, Liverpool, Manchester United, Manchester City e Real Madrid janë vënë pas yllit anglez dhe janë gati të shpenzojnë milionë euro për transferimin e tij. Hans-Joachim Watzke, CEO i

Borussias së Dortmundit, ka zbuluar se do të zhvillojnë bisedime me mesfushorin dhe familjen e tij pas përfundimit të Kupës së Botës. "Mendoj se sapo të përfundojë Kupa e Botës do të kemi një diskutim

të përgjithshëm për atë që ai dëshiron vërtet. Me të, me prindërit e tij, me të cilët kemi një marrëdhënie shumë të ngushtë. Dhe, sigurisht, me këshilltarin e tij", ka thënë Watzke për "Bild".

SHKURT

Brightoni interesohet për Muriqin

Reprezentuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, po shkëlqen në La Liga me skuadrën e Mallorcas. Forma e mirë e sulmuesit shtatëmetërës ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve evropiane. Fillimisht interesim për Muriqin treguan Sevilla e Villarreali, kurse tash për sulmuesin ka shfaqur interesim edhe skuadra nga Premierë Liga, Brighton. Ish-lojtari i Lazios në këtë edicion ka realizuar 8 gola dhe e ka bërë 1 asistim. Prizrenasi ka kontratë me Mallorcan deri në vitin 2027, ndërsa klubi spanjoll thuhet se ia ka vendosur klauzolën e shkëputjes së kontratës prej 30 deri në 40 milionë eurosh.

'Daily Mail': Guardiola vendos për të ardhmen pas Kupës së Botës

Trajneri i Manchester City, Pep Guardiola, do të flasë për të ardhmen e tij pas Kupës së Botës. Sipas raportimit të "Daily Mail", Guardiola do ta përdorë pushimin për ta shqyrtuar të ardhmen e tij në klub. Kontrata e tij skadon në fund të sezonit dhe ai ende nuk ka vendosur nëse do ta vazhdojë karrierën e tij me kampionin e Premierligës. Trajneri do të fluturojë për në Abu Dhabi për takime me drejtuesit kryesorë të Cityt, ku ai do t'i informojë ata për planet e tij për të ardhmen. Mbetet të shihet se cili do të jetë vendimi i spanjollit.

Allegri 'kërcënon' Napolin në garën për titull

Juventusit në mënyrë befasuese bëri një mbyllje fantastike këtij viti, teksa përballë Lazios siguroi fitoren e gjashtë radhazi. "Zonja e Vjetër" e mbylli vitin në vendin e tretë duke parakaluar pikërisht Lazion, por kreu mbetet ende larg, minus 10 pikë. Trajneri Max Allegri ka thënë se Napolin i duhen 90 pikë për ta fituar titullin. "Napoli po bën gjëra të jashtëzakonshme, por të shohim, për të fituar titullin i duhen minimumi 90 pikë. Gjashtë javë më parë askush nuk e besonte se do të mbyllnim vitin në vendin e tretë. Tani t'i karkikojmë bateritë", u shpreh Allegri.

Russell: Kur kalova fundin para syve më kaloi e gjithë karriera ime në Formula 1

Piloti britanik George Russell arriti ta presë i pari vijën e finishit në garën e Brazilit zhvilluar në pistën e Interlagos, sukcesi i tij i parë në karrierë në Formula 1. Një festë e madhe për të dhe skuadrën Mercedes, që korri suksesin e parë sezonal. Që kjo do të ishte fundjava e përkryer për Mercedesin u kuptua që ditën e shtunë, kur Russell fitoi garën sprint. "Ishte një ndjesi fantastike dhe një falënderim i madh shkon për skuadrën, që bëri të mundur këtë sukses të dyfishtë", ka thënë Russell, që la pas shokun e tij të skuadrës Lewis Hamilton, i dyti. "Ky sezon ka qenë me shumë emocione dhe e tillë ishte edhe kjo garë. E kontrollova garën dhe arrita një fitore të madhe edhe pse Lewis ishte i shpejtë. Gjithsesi, në fund fitova dhe pasi kalova vijën e finishit dhe po kthehesha në bokse, para syve të mi kaloi e gjithë karriera ime. Falënderoj të gjithë ata që më dhanë mundësinë të arrija këtë fitore", ka deklaruar Russell.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje të Aktgjykimit nr. Ref AGJ. 1583/20 në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese datë 09 Korrik 2020, Neni 38 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr.06/L-055, Neni 9 Rregullore Nr. 04/2022 Për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, Vendimit KGJK-së Nr. 413/2022 të datës 03 nëntor 2022 dhe Vendimit KGJK-së Nr. 414/2022 të datës 03 nëntor 2022, shpall:

KONKURS PUBLIK PËR POZITËN ADMINISTRATOR

Pozitat e publikuara:

- ADMINISTRATOR në GJYKATËN KOMERCIALE – 1 (një) pozitë
- ADMINISTRATOR në GJYKATËN THEMELORE PRIZREN – 1 (një) pozitë

PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS:

Titulli i pozitës së punës: **ADMINISTRATOR;**

Institucioni:

- Gjykata Komerciale: - 1 (një) pozitë;
- Gjykata Themelore Prizren: - 1 (një) pozitë;

Kategoria Funktionale: *niveli drejtues*

Grada e Vendit të Punës: *Koeficienti dhjetë (10)*

Lloji i Vendit të Punës: *me afat të caktuar – mandat pesë (5) vjeçar, me orar të plotë*

Departamenti/Divizioni/Njësia: *Zyra e Administratorit*

Raporton tek: *i përgjigjet dhe i raporton Kryetarit të Gjykatës*

Vlerësimi i performancës: *bëhet nga Kryetari në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit*

Vendndodhja: *Gjykatë përkatëse*

Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm sipas Vendimit KGJK-së Nr. 256/2022

Kohëzgjatja e kontratës së punës: *Kontratë pune me afat të caktuar – mandat pesë (5) vjeçar – përfshi*

periudhën provuese 6 muaj

Arsyeja e rekrutimit: *plotësim i pozitave të lira sipas organogramit dhe planifikimit të punësimit për vitin 2022*

Oëllimi i vendit të punës: *(përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)*

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e veprimtarive dhe funksioneve administrative të gjykatës në mënyrë autonome, me qëllim të realizimit të mandatit dhe misionit të gjykatës duke siguruar bashkëpunim dhe koordinim mes strukturave organizative të administratës së gjykatës, në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Detvat Krvesore: *(përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)*

- Udhëheqje, menaxhon dhe mbikëqyrë aktivitetet administrative të gjykatës me qëllim të realizimit të planit vjetor të punës së gjykatës, në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit..... 20%
- Në bashkëpunim me udhëheqësit e zyrave të gjykatës dhe ndihmës administratorët e degëve, analizojnë dhe vlerësojnë proceset dhe procedurat e brendshme të gjykatës dhe në pajtim me Kryetarin, rekomandojnë për ndryshime / përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës15%
- Siguron kontroll të brendshëm, zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve administrative në Gjykatë, në kohë dhe me kosto efektive 15%
- Në koordinim me udhëheqësit e zyrave, sipas nevojës dhe legjislacionit në fuqi, cakton stafin administrativ, në detyra të caktuara për të siguruar veprimtarinë efektive dhe efikase të gjykatës;.....10%
- Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli për stafin administrativ të gjykatës;10%
- Përmes udhëheqësve të zyrave mbikëqyrë mirëmbajtjen e dosjeve të gjykatës në formë të plotë dhe të saktë, regjistrimin dhe arkivimin e dosjeve të gjykatës dhe lëndëve të mbyllura, sigurinë e gjykatës, mirëmbajtjen e saktë të financave, raporteve statistikore;.....10%
- Përgjegjës për hartimin e raporteve të punës së gjykatës si dhe ndërmerr detyra dhe përgjegjësi të tjera, siç mund të caktohen nga kryetari i gjykatës në pajtim me legjislacionin në fuqi, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli;.....10%
- Është përgjegjës për mbikëqyrjen e vijueshmërisë në punë të stafit administrativ, bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara dhe përgatitje raportet javore të punës;.....10%

Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës: *(cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)*

- Zëvendës administrator** (në Gjykatën e Apelit, Gjykatën Themelore Prishtinë dhe Mitrovicë)
- Ndihmës administrator** (i raporton Gjyqtarit mbikëqyrës ndërsa vlerësimi i performancës bëhet nga Gjyqtari mbikëqyrës në koordinim me Administratorin)
- Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike** (i raporton për çështje administrative ndërsa vlerësimi i performancës bëhet nga Kryetari në koordinim me Administratorin)
- Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve;**
- Udhëheqës i Zyrës për Shërbime të Përbashkëta;**
- Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa;**
- Zyrtar certifikues;**
- Zyrtar i lartë i personelit** (në Gjykatën Themelore Prishtinë dhe Mitrovicë);
- Zyrtar i personelit;**

Niveli i përgjegjësisë financiare: *(p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)*

- Administratori i gjykatës mbikëqyrë: Mirëmbajtjen e saktë të financave;**

Shkathtësitë e kërkuara: *(aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)*

- Njohuri mbi organizimin dhe administrimin e sistemit gjyqësor.....E nevojshme;
- Përvojë profesionale në sistemin gjyqësor ose ndonjë organizatë që ka lidhje me sistemin e drejtësisë.....E nevojshme;
- Përvojë në zhvillimin organizativ, planifikim, përgatitje dhe ekzekutim të buxhetit, planifikim dhe menaxhimin e procesit të punës, menaxhim të burimeve njerëzore, bashkëpunim me publikun, mediat dhe shoqërinë civile si dhe njohuri për përdorimin e teknologjisë informativë.....E nevojshme;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit.....E nevojshme;
- Aftësi për ruajtjen dhe kultivimin e marrëdhënieve efektive të punës me institucionet publike të niveleve të ndryshme, personat fizike dhe partneret ndërkombëtare.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel).....E nevojshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: *(kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)*

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë në ndonjë nga fushat: Juridik, Ekonomik apo Administratë Publike.....E nevojshme;
- Së paku pesë (5) vite përvoja pune profesionale nga të cilat së paku dy (2) vite përvojë menaxheriale.....E nevojshme;

Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka: *(p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)*

- Nuk ka**

DOKUMENTET E NEVOJSHME

- Kandidatët në pajtim me nenin 10 Rregulloren Nr. 04/2022 Për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e Fakultetit të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Certifikatën shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike;
- Certifikatën nga evidenca penale të lëshuar nga gjykata;
- Dëshminë mbi përvojën e punës.

- Informatat e siguruar nga punëdhënësi për së paku pesë (5) vitet e fundit të përvojës profesionale të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- përshkrimin e detyrave të punës;
- performancën profesionale;
- masat disiplinore; dhe,
- çështjet tjera që konsiderohen relevante për procesin, të shoqëruara edhe me dokumente mbështetëse, për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale, siç parashihen me këtë rregullore dhe me dispozitat e ligjeve të aplikueshme.

- Kandidati mund t'i dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:

- Publikime profesionale apo akademike; dhe/ose,
- Informata për pjesëmarrje në trajnime.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR KANDIDATËT

I. Neni 10 paragrafi 6 Rregulloren Nr. 04/2022 Për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, Vetëm kandidatet e regjistruar në Këshilli, në afatin e paraparë me konkurs për aplikim dhe dokumentacion të kompletuar, kanë të drejtë t'i nënshtrohen procesit të rekrutimit. Ndërsa, kandidatet të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar, sipas kritereve dhe kërkesave të konkursit nuk do të merren parasysh.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formulari mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org);

- Shkarko aplikacionin:**

MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Këshill në formë fizike, përmes postës së rregullt ose postës elektronike: KGJK.BurimetNjerzore@gjyqesori-rks.org; i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Afati për dorëzimin e aplikacionit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit.

Data e fillimit të aplikimit: **15 NËNTOR 2022**

Data e fundit të aplikimit: **29 NËNTOR 2022**

- Sekretariati i KGJK-së,**
- Rruga "Luan Haradinaj" nr. 133, Prishtinë, në Zyrën e Pranimit.**
- 10000 Republika e Kosovës**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Sudski savet Kosova, u skladu sa presudom br. AGJ Ref. 1583/20 u slučaju br. KO203/19 Ustavnog suda od 9. jula 2020. godine, član 38 Zakona o Sudskom savetu Kosova br. 06/L-055, član 9 Pravilnika br. 04/2022 o postupku zapošljavanja, izbora i zasnivanja radnog odnosa za sudske administratore, Odlukom SSK-a br. 413/2022 od 3. novembra 2022. godine i Odlukom SSK-a br. 414/2022 od 03.11.2022.godine, objavljuje:

JAVNI KONKURS ZA POZICIJU
ADMINISTRATORA

Objavljene pozicije:

1. ADMINISTRATOR u PRIVREDNOM SUDU – 1 (jedna) pozicija
2. ADMINISTRATOR u OSNOVNOM SUDU PRIZREN – 1 (jedna) pozicija

OPIS RADNIH ZADATAKA:

Naziv radnog mesta: **ADMINISTRATOR**;
Institucija:

- Privredni sud: - 1 (jedna) pozicija;
- Osnovni sud Prizren: - 1 (jedna) pozicija;

Funkcionalna kategorija: *nivo upravljanja*

Radno mesto/ Koeficijent: *koeficijent deset (10)*

Vrsta radnog mesta: *na određeno – mandat od pet (5) godina, sa punim radnim vremenom*

Departman/Odsek/Jedinica: *Kancelarija administratora*

Izveštava: *odgovara i podnosi izveštaj predsedniku suda*

Ocenjivanje učinka: *vrši predsednik u koordinaciji sa generalnim direktorom Sekretarijata Saveta*

Mesto: *Odgovarajući sud*

Postupak prijave: *Spoljni konkurs po odluci SSK-a br. 256/2022*

Trajanje ugovora o radu: *Ugovor o radu na određeno vreme - pet (5) godina - uključujući probni period od 6 meseci*

Razlog prijema: *popunjavanje upražnjenih radnih mesta prema organizacionoj šemi i planiranju zapošljavanja za 2022.*

Namena radnog mesta: *(kratak opis svrhe radnog mesta i šta ovo radno mesto treba da postigne)*

Rukovođenje i nadzor aktivnosti i upravnim funkcijama suda na samostalan način, u cilju ostvarivanja mandata i misije suda obezbeđivanjem saradnje i koordinacije između organizacionih struktura sudske uprave, u saradnji sa predsednikom suda i u koordinaciji sa Sekretarijatom Saveta, u skladu sa važećim zakonima i normativnim aktima koje usvaja Savet.

Glavni zadaci: *(kratak opis glavnih zadataka, rangiranih po važnosti i opis procenta vremena koje treba potrošiti na svaki zadatak)*

- Rukovodi i vrši nadzor administrativne poslove suda u cilju realizacije godišnjeg plana rada suda, u saradnji sa predsednikom suda i u koordinaciji sa Sekretarijatom Saveta..... 20%
- U saradnji sa rukovodiocima sudskih kancelarija i pomoćnicima administratora ogranka, analizira i ocenjuje interne procese i procedure suda i u dogovoru sa predsednikom predlaže izmene / poboljšanja u cilju povećanja efikasnosti rada. 15%
- Obezbedi unutrašnju kontrolu, razvoj i sprovođenje svih upravnih poslova u Sudu, blagovremeno i ekonomično 15%
- U koordinaciji sa rukovodiocima kancelarija, u skladu sa potrebama i važećim zakonima, imenuje administrativno osoblje, na određenim poslovima kako bi se obezbedio delotvoran i efikasan rad suda;.....10%
- Nadgleda sprovođenje zakona na snazi i normativnih akata usvojenih od strane Saveta za administrativno osoblje suda;10%
- Preko šefova kancelarija vrši nadzor vođenje sudskih spisa u potpunom i tačnom obliku, evidentiranje i arhiviranje sudskih spisa i zatvorenih predmeta, obezbeđenje suda, pravilno vođenje finansija, statističkih izveštaja;.....10%
- Odgovoran je za sastavljanje izveštaja o radu suda i preuzima druge poslove i obaveze koje mu odredi predsednik suda u skladu sa važećim zakonima, pravilima i postupcima koje utvrđuje Savet;.....10%
- Odgovoran je za praćenje kontinuiteta rada administrativnog osoblja, vrši redovne procene osoblja pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuku kako bi se obezbedilo obavljanje njihovih dužnosti na nivou zahtevanih standarda i priprema nedeljne izveštaje o radu;10%

Odgovornosti za nadzor i ocenjivanje učinka: *(koje pozicije odgovaraju ovoj poziciji i koje pozicije su vršile evaluaciju učinka za ovu poziciju, ako ih ima)*

- **Zamenik administratora** (u Apelacionom sudu, Osnovnom sudu u Prištini i Mitrovici)
- **Pomoćnik administratora** (odnosi izveštaj nadzornom sudiji, dok ocenu rada vrši nadzorni sudija u koordinaciji sa administratorom)
- **Šef Kancelarije za pravnu podršku** (izveštava o administrativnim pitanjima dok ocenu učinka vrši predsednik u koordinaciji sa administratorom)
- **Šef Kancelarije za upravljanje predmetima;**
- **Šef Kancelarije za zajedničke usluge;**
- **Šef Kancelarije za budžet i finansije;**
- **Službenik za overu;**
- **Viši kadrovski službenik** (u Osnovnom sudu u Prištini i Mitrovici);
- **Kadrovski službenik;**

Nivo finansijske odgovornosti: *(npr. budžet za koji je odgovorna pozicija, nivo ovlašćenja za troškove)*

- **Sudski administrator nadgleda:** pravilno održavanje finansija;

Potrebne veštine: *(veštine i sposobnosti potrebne za ovu poziciju)*

- Poznavanje organizacije i administracije pravosudnog sistema.....Potrebno;
- Profesionalno iskustvo u pravosudnom sistemu ili bilo kojoj organizaciji koja je povezana sa pravosudnim sistemom.....Potrebno;
- Iskustvo u organizacionom razvoju, planiranju, pripremi i izvršenju budžeta, planiranju i vođenju procesa rada, upravljanju ljudskim resursima, saradnji sa javnošću, medijima i civilnim društvom kao i poznavanje upotrebe informacionih tehnologija..... Potrebno;
- Izvrsne komunikacione veštine..... Potrebno;
- Sposobnost održavanja i negovanja delotvornih radnih odnosa sa javnim institucijama različitih nivoa, fizičkim licima i međunarodnim partnerima.....Potrebno;
- Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel).....Potrebno;

Obrazovne, stručne kvalifikacije i radno iskustvo: *(potrebne kvalifikacije i iskustvo za ovu poziciju)*

- Univerzitetska diploma važeća na Kosovu u bilo kojoj od oblasti: Pravo, Ekonomija ili Javna Administracija.....Potrebno;
- Najmanje pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva, od čega najmanje dve (2) ..godine rukovodećeg iskustva.....Potrebno;

Neuobičajene karakteristike radnog okruženja ako ih ima: *(npr. vanredne opasnosti na radnom mestu, fizički pritisci ili rizici od izlaganja opasnim materijama ili upotrebe opasne opreme koji proizilaze iz prirode radnog mesta ili lokacije radnog mesta)*

- Nema

POTREBNA DOKUMENTACIJA

1. Kandidati u skladu sa članom 10 Pravilnika br. 04/2022 za postupak prijema, izbora i zasnivanja radnog odnosa za sudske administratore potrebno je dostaviti sledeću dokumentaciju:
 - 1.1 Popunjena aplikacija sa potrebnim podacima;
 - 1.2 Uverenje o državljanstvu Republike Kosovo;
 - 1.3 Fakultetska diploma važeća u Republici Kosovo;
 - 1.4 Zdravstveno uverenje za procenu psiho-fizičkih sposobnosti;
 - 1.5 Potvrda iz krivičnog dokaza koju izdaje sud;
 - 1.6 Dokaz o radnom iskustvu.
2. Informacije koje daje poslodavac za najmanje poslednjih pet (5) godina radnog iskustva, koje uključuju, ali se ne ograničavaju na:
 - 2.1. opis posla;
 - 2.2. profesionalni učinak;
 - 2.3. disciplinske mere; i,
 - 2.4. druga pitanja koja se smatraju relevantnim za proces, uz prateću dokumentaciju, za ocenu ličnog integriteta i profesionalnih veština, kako je predviđeno ovom pravilnikom i odredbama važećih zakona.
3. Kandidat može dostaviti i sledeću dokumentaciju:
 - 3.1. Stručne ili akademske publikacije; i/ili,
 - 3.2. Informacije o učešću na obukama.

VAŽNO OBAVEŠTENJE ZA KANDIDATA

- I. Član 10 stav 6 Pravilnika br. 04/2022 za postupak prijema, izbora i zasnivanja radnog odnosa za sudske administratore, pravo na prijem u radni odnos imaju samo kandidati prijavljeni u Savetu, u predviđenom roku sa konkursom za prijavu i kompletnom dokumentacijom. U međuvremenu, kandidati koji se nisu prijavili u roku na konkurs, kao i oni koji su se prijavili u roku, a nisu dostavili kompletnu dokumentaciju, prema kriterijumima i uslovima konkursa, neće biti razmatrani.

OBRAZAC ZA PRIJAVU

- obrazac se može preuzeti sa zvaničnog sajta SSK. (www.gjyqesori-rks.org);

- **Preuzmite aplikaciju:**

NAČIN PRIJAVLJIVANJA

Zahtev zajedno sa pratećom dokumentacijom može se podneti Savetu u fizičkom obliku, putem pošte ili e-pošte: KGJK.BurimetNjerzore@gjyqesori-rks.org; koji se registruje i svakom kandidatu se dostavlja potvrda o prihvatanju prijave.

ROK ZA PRIJAVU

Rok za podnošenje prijave je petnaest (15) dana od objavljivanja konkursa.

Datum početka prijave: **14. novembar 2022**

Rok za prijavu: **28. novembar 2022**

• Sekretarijat SSK,

• Ulica „Luan Haradinaj“ br. 133, Priština, u kancelariji za prijem.

• 10.000 Republika Kosovo

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “INBUREP” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811355727 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “INBUREP” D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811355727 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “INBUREP” L.L.C. Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 811355727 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Oferte për shitjen e patundshmerise

Zija (Gjimshit) Bilalli nga Dragashi (Brrut) me adres banimi Rr. Meleq Begu nr.23 Prizren i cili eshte bashkepronar ne pjesen prej 1/2 e pjeses ideale te patundshmeris , me numer te Njesis kadastrale P- 71813068 - 02460 -0 ne vendin e quajtur " Partizani " Toke ndertimore 239m2 obor dhe 1.90m2 shtepi - Ndertese , me siperfaqe te pergjithshme prej 429m2 zona Kadastrale Prizren.

Nga pjesa e vet ideale ofron per shitje siperfaqen e pergjithshme prej 214.5 m2 (apo 1/2 e pjeses ideale) te patundshmerise me te dhenat si me lart, ne shumen e pergjithshme prej 250.000 (me shkronja : Dyqinde e Pesedhete Mij euro) , Prizren . 11.11.2022

Ofertuesi :
Zija (Gjimshit) Bilalli



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Visar Vokrraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: -X, XI, XII-të SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Freskim Behrami B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811490656.

- Shukrije Bajrami shpall të pavlefshme dëftesat e vitit: I, II, III të SHMLE "Hasan Prishtina".

- Sh.P.K “Anis” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810140575.

- Klubi Hendbollistik "Vushtrria" shpall të pavlefshme Certifikatën e numrit Fiskal: 601086714.

- Shkendije Musa shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLE “Hasana Prishtina”.

- Nazmi Tahiri B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 70708973.

- “Ballkan Shped” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 70417426.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së –IX- të SH.M.T “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

